

## **PERMBLEDHJE JOTEKNIKE**

**Emri Tregtar:** “MATERIALE NDERTIMI ARMIRI” sh.p.k

**Administrator:** Haqif Cengu

**Nipt :** K68321206W

**Aktiviteti:** “Prodhim blloqe betoni”

**Vendodhja:** Lagjia Nr.3, Rruga Nacionale Kukes- Gostil Km1, Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.Pasurie 42/133, Kukes.

Klasifikimi i aktivitetit sipas shtojces se ligjit 60/2014:

<b>ID: 3.1 Industria minerare e)</b>	<b>Perzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera te çimentos.</b>
--------------------------------------	--

## **Informacion mbi subjektin**

Subjekti “**MATERIALE NDERTIMI ARMIRI**” sh.p.k cili kerkon te pajiset me Leje Mjedisi Tipi B, per aktivitetin ”Prodhim blloqe betoni”, eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 01/03/2007 dhe themeluar ne daten 12/02/2007 me Nr. NIPTI K68321206W, forma ligjore SHPK. Subjekti zhvillon aktivitetin e prodhimit, tregimit dhe shperndarjes se blloqeve te betonit. Duke qene keto produkte jane mjaft te perdorura ne industrine e ndertimit edhe kerkesat per prodhimin, shtimin e kapacitetit dhe permiresimin e cilesise kane ardhur duke u rritur, kjo shoqeri do te ushtroi aktivitetin “Prodhim blloqe betoni” , me vendodhje Lagjia Nr.3, Rruga Nacionale Kukes- Gostil Km1, Zona Kadastrale, Nr.2315, Nr.Pasurie 42/133, Kukes.

## **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT DHE VEPRIMTARISE**

### **Qellimi i ketij aktiviteti eshte prodhimi i blloqeve te betonit.**

Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne prodhimin e produktit perfundimtar qe jane blloqet e betonit, do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij. Impianti i prodhimit betonit, eshte prodhim i ri, i nje teknologjie bashkekohore dhe brenda parametrave te lejuara. Kuptohet qe me kalimin e kohes dalin prodhime te reja dhe me funksionale, por ne kete rast prodhimet e reja, nuk kane ndryshuar parimin e prodhimit, as procesin vetem kane permiresuar sistemin elektrik, duke u automatizuar dhe duke instaluar filtra me te reja per reduktimin e ndotjes.

### **Vendodhja e projektit**

Vendodhja e objektit perputhet plotesisht me synimin e kompanise qe ti afrohet tregut te perdorimit te materialeve te ndertimit, si material te gateshme per sektorin e ndertimit.

Zgjedhja e shoqerise per vendosjen e impiantit eshte në rrugen Kukes-Gostil, km1, Impianti do te vendoset brenda siperfaqes se ambjentit qe disponon. Sipas natyres se operacioneve qe realizojne teknologjia e projektit perbehet nga nje impiant per prodhimin e blloqeve te betonit dhe mjete transportuese dhe ndihmese.





### **Shpjegimi i skemes teknologjike te impiantit.**

Si fillim ne kazan vendoset lenda e pare inerte qe do te perdoret e cila me pas kalon ne betoniere ku bashkohet edhe me element te tjere si çimento dhe uje te cilet se bashku formojne betonin qe do te perdoret ne prodhimin e elementeve blloqe betoni Pas pergatitjes se betonin ne betoniere ai kalon ne presen ku behet stampimi i elementeve ne forma dhe madhesi te ndryshme, dhe pasi elementi ka marre formen e kerkuar kalon ne vendin ku behet tharja e elementeve te sapo pergatitur. Pas kesaj faze blloqet kalojne ne vendin ku behet tharja e plote dhe magazinimi i elementeve dhe ne fund pasi elementet jane thare plotesisht atehere behet edhe paketimi i tyre ne

pileta druri te mbeshtjella me qese dhe te lidhura me litar ne menyre qe te mos kemi incidente (renie apo dhe thyerje te elementeve). Kapaciteti i ketij aktiviteti eshte 200 blloqe/dite.

**Makinerite qe perdoren ne kete aktivitet jane :**

1. Kazana (silos) per mbajtjen e inerteve kryesisht rere;
2. Betoniere qe perdoret per pergatitjen e betonit qe do te perdoret per prodhimin e blloqeve.
3. Makineri per paketim;
4. Makineri stampimi per forma te ndryshme te markave
5. Mbajtese per magazinimin e blloqeve.

Lenda e pare perbehet nga inerte lumore, ose guri gelqeror (granile te ndryshme) qe sigurohen nga tregu vendas si dhe cemento qe sigurohet nga subjekte te licensuara te vendit.

**Inertet me te zakonshme qe perdoren jane:**

1. Rere e imet deri ne 5 mm;
2. Granil deri ne 10 mm;
3. Granil deri ne 20 mm;

Impianti i prodhimit betonit, eshte prodhim i ri, i nje teknologjie bashkekohore dhe brenda parametrave te lejuara. Kuptohet qe me kalimin e kohes dalin prodhime te reja dhe me funksionale, por ne kete rast prodhimet e reja, nuk kane ndryshuar parimin e prodhimit, as procesin vetem kane permiresuar sistemin elektrik, duke u automatizuar dhe duke instaluar filtra me te reja per reduktimin e ndotjes.

Pra mund te themi se nga ky aktivitet nuk pritet te kete ndikime mjedisore te dukshme pasi:

- Nuk ka prodhim te mbetjeve te rrezikshme
- Nuk shkakton ndotje te tokes dhe shkakime te ndryshme te lengta apo te ngurta
- Nuk ka shkarkime te gazrave apo tymrave te pa kontrolluara ne ajer
- Zhurmat ne mjedisin e punes per efekt te punes ne impiantit do te jene brenda normave. Keto zhurma jane te patransmetueshme jasht ambjenteve te aktivitetit dhe nuk priten te kene ndikim ne popullaten perreth.
- Eshte parashikuar marrja e te gjitha masave per mbrojtjen ne pune dhe masat per evitimin e rrezikut te zjarrit.



Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve, ne ajer, te pluhurave dhe zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore te territorit.

***Ne projekt per mbrojtjen nga pluhuri do te merren keto masa.***

Per te eleminuar pluhurin qe krijohet gjate pergatitjes se betonit, transportit te lendes se pare dhe asja perfundimtare dhe levizjes se mjeteve te punes, materiali do te laget me uje, ndersa makinat e transportit do te mbulohe me mushama.

***Per mbrojtjen nga gazet e motorreve dizel do te merren keto masa.***

Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore.

Ato do te jene te pajisura me marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.

**Per te ulur ne minimum ndikimet nga zhurmat do te merren keto masa:** Makinerit e punes, te ngarkimit dhe transportit te minerialeve do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura ne marmita selenciatore te pakesimit te zhurmave.

Brenda zones se aktivitetit vlerat e zhurmave jane gjithmone poshte normave te lejuara. Jane bere matje te nivelit te zhurmave ne disa objekte te ngjashme ku perdoren te njejtat makineri dhe del se ne distancen 10m nga makinerit zhurmat arrijne nivelin 60 dB.

**Masat parandaluese**

Masat qe duhen konsideruar per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:

- Parandalimi i shkarkimeve te lendes pare ne mjedis,
- Lidhur me mbetjet e ngurta urbane te grumbulluara te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara ose me subjektin e grumbullimit te mbetjeve urbane.
- Te mirembahet sistemi i mbrojtjes nga zjarri ne menyre qe te perballoje rastet e avarive te ndryshme.
- Punonjesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit te punimeve gjate proceseve te punes. Punimet e mirembajtjes te kryhen ne perputhje me kushtet teknike te punes.
- Te shtohet siperfaqja e gjelber dhe te mbillet nje brez pemesh te larta pergjate murit rrethues te prones, ne menyre qe te reduktoje impaktin ne peisazh.

Drejtuesi i punimeve duhet te beje vazhdimisht instruksionin teknik te punetoreve dhe ne vecanti te drejtuesve te mjeteve motorrike. Per mbrojtjen nga zhurmat, punonjesit e aktivitetit do te perdorin kufje nese do te jete e nevojshme dhe pse ne kete lloj aktiviteti zhurmat jane minimale dhe Brenda normave te lejuara. Per reagimin e menjehershem ndaj aksidenteve te mundshem humane, aktiviteti do te kete edhe nje ambient te mbyllur (ambulance) ku do te mbahet kutia e ndihmes se shpejte ne rast aksidenti ose demtim shendeti te njerzve.

## **Konkluzione**

- Zbatimi i projektit nuk do te kete pasoja negative te mundshme ne mjedisin e zones;
- Procesi teknologjik i prodhimeve te betonit dhe produkteve te krijuara prej tij nuk shoqerohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Ujerat që përdoren në linjën e prodhimit te betonit nuk kanë teprica sepse dozohen ne sasi te percaktuara;
- Meqenëse lendet e para te përdorura për prodhimin e betonit jane inerte, këto ujera nuk kanë elemente qe mund të kontaminojnë mjedisin ujqor prites, sipërfaqësore, nentokësore apo token;
- Ky aktivitet nuk perdore lende te rrezikshme per shendetin e punonjesve si dhe te popullsisë perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata;
- Ky projekt nuk sjell emetime te gazeve ne atmosphere;
- Gjatë procesit të ngarkim – shkarkimit te materialit behet pluhur i lehte dhe drejtuesit e shoqerise do te marrin masa per sperkatjen me uje, për paisjen e punëtoreve dhe manovratorve te mjeteve me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, si kominoshe pune, kapele mbrojtese, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri;
- Niveli i zhurmave qe vijne nga automjetet dhe pajisjet e tjera jane brenda normave te lejuara. Nuk perbejne problem shqetesues per punonjesit dhe as per banoret e zones perreth qe jane ne nje distance te konsiderueshme.
- Furnizimi me uje do te sigurohet privatisht nga nga vet subjekti sipas kontrates bashkengjitur si document me vete;
- Furnizimi me energji elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues qe mbulon zonen duke plotesuar te gjitha kushtet teknike;
- Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlere arkitektonike dhe kulturore , pra nuk kemi ndryshime apo demtime te saj duke qene se nuk ekziton ne kete territori;
- Per nje pune sa me optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punetoret e manovratoret njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesi i punimeve te firmes;

## Rekomandime

Duke ditur se gjate proceseve te punes ne linje emetohen në mjedis pluhur i lehte, ka zhurma te makinerive për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe per te ulur ne maksimum impaktin ne mjedis, duhet të:

- Te behet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike te automjeteve;
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis;
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te pluhurit ne ajer;
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik;
- Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne bashkepunim me Njesine e Qeverisjes Vendore;
- Te sigurohet furnizim i mire me energji elektrike per te reduktuar ose shmangur oret e punes se gjeneratorit dhe nderprejre te procesit te punes;
- Te aplikohet lagia e shesheve per te reduktuar pluhurin;
- Te mos depozitohet lende e pare ne sasi te medha, per te reduktuar demtimin e peizazhit dhe te erozionit te eres dhe te shiut;
- Te kryhet larja e automjeteve te transportit ne menyre periodike jasht aktivitetit;
- Te vendosen kosha dhe postera sensibilizues per mbajtjen paster te ambjenteve;  
Investitori te respektoje detyrimet e vena ne Lejen Mjedisore qe do te miratohet nga Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM);
- Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe ndryshimeve te tij;
- Te respektohen normat e teknikes se sigurimit ne pune nga punetoret;